

VENDIM
Nr.17, datë 6.3.2009

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN
PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË
KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pikës 7 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar si më poshtë:

a) Në nenin 2, në fillim të fjalisë pas fjalës “të gjithë” hiqen fjalët klientë tariforë dhe vendoset fjala subjektet.

b) Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

Pika 1, aty ku thuhet ERE ndryshon dhe bëhet: “Enti Rregullator i Energjisë”.

Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përmbajtjen:

“3/1. Subjekt në kuptim të kësaj rregulloreje do të thotë një person fizik ose juridik që kërkon të përfitojë statusin e klientit të kualifikuar”.

Pika 5 ndryshon dhe bëhet:

“OSSH është personi i licencuar për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe atë të furnizimit publik me pakicë”.

Pika 6 ndryshon dhe bëhet:

“OST është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike”.

Pika 7 shfuqizohet.

c) Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

Germa “a”) ndryshon dhe bëhet:

Plotëson kriterin e vendosur vit pas viti nga Bordi i Komisionerëve në zbatim të nenit 48, pika 1”.

Germa “b”) ndryshon dhe bëhet:

“Paraqet në ERE kopje të noterizuar të librezës së pagesave të energjisë elektrike dhe kopje të faturave të energjisë elektrike, të noterizuara, për vitin e mëparshëm, sipas të cilave ka likuiduar detyrimet ndaj OSSH deri në momentin që aplikon në rastin e klientëve ekzistues.”.

Germa “c”) ndryshon dhe bëhet:

“Subjekti demonstroi në ERE kategorinë e klientit së cilës ai i përket apo do t'i përkasë.”.

d) Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1, në fillim të fjalisë bëhet:

“Çdo subjekt ekzistues apo i perspektivës”

Pika 2 shfuqizohet.

Pika 3 bëhet pika 2 dhe ka përmbajtjen:

“Brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës, Bordi pasi konstaton rregullshmërinë e aplikimit, vendos për dhënien ose jo të statusit të klientit të kualifikuar.”.

e) Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

“Në pikën 1, pas fjalëve “duhet të njoftojë” hiqet fjala “Furnizuesin” dhe vendoset “OSSH.”.

Në pikën 2 në fund të fjalisë shtohen fjalët:

dhe të njoftojë OSSH apo OST, si dhe KESH/FPSH dhe ERE-n”.

f) Në nenin 7 shfuqizohet germa “b”),

g) Në nenin 8, në pikën 1 dhe 3, aty ku thuhet “furnizuesin publik”, ndryshon dhe bëhet “OSSH.”.

gJ) Në nenin 10, në titullin e nenit dhe në paragrafin e parë ku thuhet “Furnizuesin publik” bëhet “OSSH/furnizuesi publik me pakicë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta